

Njoftim për të drejtat e punëmarrësit: Leje për arsye Sigurie dhe Shëndetësore

Nëse punoni me kohë të pjesshme apo të plotë në ndonjë biznes të çfarëdolloj madhësie ose jofitimprurës në Nju-Jork apo nëse punoni në një familje nju-jorkeze si punëtor/e shtëpiak/e, ju keni të drejtën e një lejeje për arsye sigurie dhe shëndetësore për t'u kujdesur për veten apo këdo që konsideroni familje. Ju e keni këtë të drejtë pavarësisht nga statusi juaj i imigracionit. Punëdhënësi juaj duhet t'ju japë këtë njoftim duke ju shpjeguar të drejtat tuaja.

Periudha e lejes për arsye Sigurie dhe Shëndetësore:

- Punëdhënësi juaj duhet t'ju ofrojë deri në **40 orë** leje në total për arsye sigurie dhe shëndetësore çdo vit kalendarik.

Duke filluar nga 1 Janar, 2021:

- Punëdhënësit me 100 apo më shumë punonjës** duhet të ofrojnë deri në **56 orë** leje në total për arsye sigurie dhe shëndetësore çdo vit kalendarik.

Viti kalendarik i punëdhënësit tuaj është: _____ deri në _____
Muaji i parë Muaji i fundit

Ju mund të përfitoni leje për arsye sigurie dhe shëndetësore me një normë prej **1 orë për çdo 30 orë pune të kryera**.

Ju keni të drejtë të **PAGUHENI** GJATË LEJES PËR ARSYE SIGURIE DHE SHËNDETËSORE NËSE:

- Punëdhënësi juaj ka 5 apo më shumë punonjës.
- Punëdhënësi juaj ka më pak se 5 punonjës por ka të ardhura neto prej 1 milion dollarësh apo më shumë. *(në fuqi nga 1 Janar, 2021)*
- Ju punoni si një punëtor/e shtëpiak/e në shtëpinë e dikujt; për shembull, dado, kujdestar/e i/e shtëpisë apo punonjës/e shoqërimi. *Shënim: Ligji mbulon 1 apo më shumë punëtorë shtëpiakë që punojnë në një shtëpi.*

Ju keni të drejtë të **MOSPAGUHENI** GJATË LEJES PËR ARSYE SIGURIE DHE SHËNDETËSORE NËSE:

- Punëdhënësi juaj ka më pak se 5 punonjës por ka të ardhura neto më pak se 1 milion dollarë.

Ju mund të mbartni orë leje të papërdorur për arsye sigurie dhe shëndetësore në vitin pasues kalendarik.

Përdorimi i lejes për arsye Sigurie dhe Shëndetësore:

- Përdoreni për shëndetin tuaj, duke përfshirë marrjen e kujdesit shëndetësor apo për t'u rikuperuar nga një sëmundje apo dëmtim.
- Përdoreni për t'u kujdesur për një anëtar të familjes që është sëmurë apo ka një takim mjekësor.
- Përdoreni kur puna juaj apo shkolla e fëmijës tuaj mbyllet për shkak të një emergjence të shëndetit publik.
- Përdoreni atë për sigurinë tuaj ose për sigurinë e një anëtari të familjes për shkak të dhunës në familje, kontakteve të padëshiruara seksuale, ndjekjes apo trafikimit njerëzor.

Punëdhënësi juaj mund t'ju kërkojë ta njoftoni paraprakisht për përdorimin e planifikuar të lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore; për shembull, për të marrë pjesë në një takim të caktuar me mjekun apo në një seancë gjyqësore. Ju nuk duhet ta njoftoni paraprakisht për një përdorim të papritur të lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore; për shembull, një sëmundje e papritur ose një urgjencë mjekësore.

Ju gëzoni të drejtën për privatësi. Ju nuk duhet t'i jepni punëdhënësit tuaj detaje se pse keni përdorur lejen për arsye sigurie dhe shëndetësore.

Nëse përdorni më shumë se tre ditë pune radhazi të lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore, punëdhënësi juaj mund t'ju kërkojë dokumentacion. Punëdhënësi juaj duhet t'ju kompensojë çdo tarifë që paguani për dokumentacionin e kërkuar. Dokumentacioni duhet të mos përfshijë detaje të shëndetit tuaj privat apo të situatës tuaj personale.

Deklaratë e kërkuar me shkrim lidhur me lejen për arsye Sigurie dhe Shëndetësore:

Punëdhënësi juaj duhet:

- T'ju japë një rregullore të shkruar për lejen për arsye sigurie dhe shëndetësore që shpjegon se si të përdorni përfitimet tuaja.
- T'ju tregojë sa leje për arsye sigurie dhe shëndetësore keni përdorur dhe sa ju ka mbetur për çdo periudhë page.

Jo Hakmarrje:

Është e paligjshme të ndëshkohet ose pushohet nga puna punonjësit për kërkimin ose përdorimin e lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore ose për raportimin e shkeljeve.



Bill de Blasio
Mayor

Consumer and
Worker Protection

Lorelei Salas
Commissioner

Kontaktoni Mbrojtësin e Konsumatorit dhe Punonjësve për të mësuar më shumë ose për të paraqitur një ankesë.

Vizitoni nyc.gov/workers | Telefononi 311 dhe pyesni për "Lejen e paguar për arsye Sigurie dhe Shëndetësore"

Ju gjithashtu mund të bëni një raportim ANONIM.